

Siguri

# Ekskluzive | Kanosi me granatë dore një zyrtar policor në Graçanicë, arrestohet 42-vjeçari



Sinjali.com

23 Korrik 2026 09:03



**Një 42-vjeçar ka përfunduar në ndalim policor, pasi dyshohet se ka kërcënuar me granatë dore një zyrtar policor gjatë një takimi në Graçanicë, raporton Sinjali.**

Sinjali mëson ekskluzivisht se bëhet fjalë për Ivan Dimiq (42 vjeç).

Sipas burimeve të Sinjalit, ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e 22 korrikut, rreth orës 21:30, në rrugën "Krajl Milutina" në Graçanicë.

Ankuesi, një zyrtar policor ( emër i njohur për Sinjalin), ka deklaruar se ishte ftuar nga i dyshuari për një takim. Sipas deklarimit të tij, pasi kishte hyrë në veturën Volvo të Ivan Dimiqit, ky i fundit e kishte kanosur për jetën, duke i treguar një granatë dore.

Pas raportimit të rastit, njësitë relevante të Policisë kanë lokalizuar dhe arrestuar të dyshuarin. Në aksion është angazhuar edhe Njësia për Hetimin e Krimeve të Rënda (NJHP), e cila ka kryer kontroll në shtëpinë dhe automjetin e tij.

Megjithëse gjatë kontrollit nuk është gjetur ndonjë granatë apo provë tjetër materiale, Policia ka vazhduar procedurat hetimore bazuar në dyshimet e ngritura dhe deklaratimet e mbledhura.

Me urdhër të Prokurorit kujdestar, ndaj Ivan Dimiqit është iniciuar rasti për veprën penale "Kanosje", ndërsa ai është dërguar në ndalim policor për 48 orë.

Hetimet lidhur me rastin janë në vazhdim.

**Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.**

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

***/GazetaSinjali/***

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



## Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

## Aktualitet

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

## Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

## Ekonomi

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

## Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

## Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

## OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

## Jetë

Fitnes  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

## Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

## Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

## Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera